

**TURHAN PASHË PËRMETI (1839-1927)**  
**SIPAS VLERËSIMIT TË SYRJA BEJ VLORËS**

Turhan Pashë Përmeti është një personalitet i njohur në historinë e shtetit shqiptar. Dy herë kryeministër, përkatësisht në vitin 1914, me qeverinë 6 mujore (17 mars - 3 shtator) të Princ Vidit dhe pas Luftës së Parë Botërore (dhjetor 1918 - janar 1920) në qeverinë shqiptare, që u krijua me vendimin e Kongresit të Durrësit, ai, padyshim, la emrin e tij në vitet e para të lindjes dhe përpjekjeve të Shqipërisë për mbijetesë. Vlerësimi i këtij personaliteti ka nuanca të ndryshme në historiografi, që në rastin më të mirë është portretizuar si shumë i mefshtë, pa njohje me realitetin, e deri vegël në duart e Esat Toptanit dhe Italisë etj.

Vlerësimin më të fundit, me gjasë më afër realitetit, e gjejmë në “Historinë e Popullit Shqiptar”, vëll.III, botim i Akademisë së Shkencave, Instituti i Historisë, Tiranë, 2007. Aty në faqet 58-59 shkruhet: “Duke iu përmbajtur sugjerimeve të Fuqive të Mëdha në radhë të parë Italisë dhe Austro-Hungarisë, princi, dhjetë ditë pas mbërritjes në Durrës [17 mars 1914], formoi qeverinë e parë me kryeministër ish-ambasadorin e Perandorisë Osmane në Petersburg, Turhan Pashë Përmetin, që mbajti edhe postin e ministrit të Jashtëm...”. Më tej në f. 126: “Qeveria e përkohshme që doli nga Kongresi i Durrësit përbëhej nga 14 anëtarë, me në krye Turhan Pashë Përmetin, i cili e kishte ushtruar këtë detyrë edhe në kohën e Princ Vidit. Pikërisht ky synim i vazhdimësisë së shtetit kombëtar duhet të ketë qenë një nga arsyet e rizgjedhjes së tij në këtë post. Nga ana tjetër, orientimi proitalian i kryeministrit mund të lehtësonte miratimin prej Romës të qeverisë së formuar në Durrës kundër vullnetit të saj dhe njëherazi mund të vlente si “leje kalimi” për delegacionin shqiptar që duhej të shkonte në Paris...”. Kurse në f. 135-137 thuhet: “Pjesa tjetër e delegacionit [në Konferencën e Paqes në Paris në mars 1912], ku bënë pjesë Turhan Pashë Përmeti, imzot Luigj Bumçi dhe Luigj Gurakuqi (ky i fundit ishte caktuar në vendin e Mit’hat Frashërit), mendonte se duhej ndjekur jo rruga e konfrontimit dhe e ashpërsimit të marrëdhënieve me përfaqësuesit italianë, por ajo e bisedimeve, për të arritur me ta një kompromis, i cili të mbështetej në respektimin e pavarësisë dhe në ruajtjen e tërësisë tokësore të vendit...”

Fraksioni me orientim proitalian, në memorandumun e tij të 14 prillit kërkoi të vendosej për një kohë të caktuar, sa të mëkëmbej shteti shqiptar, jo sistemi i mandatit, por ai i “ndihmës” a, siç thuhej në memorandum, i “asistencës dashamirëse” të njerës prej Fuqive të Mëdha aleate, të cilën do ta

zgjidhte vetë qeveria shqiptare. Kjo fuqi, siç lihej të kuptohej në memorandum, do të ishte Italia, “ndihma” e së cilës duhej të ishte e tillë që të pajtohej me pavarësinë e sovranitetin e shtetit shqiptar dhe të mos i shërbente Romës për kolonizimin e vendit.

Propozimet e këtij fraksioni tregojnë se ai u kujdes të mënjanonte mandatin mbi Shqipërinë. Por, siç dëshmojnë memorandumet e prillit të 1919-ës, të gjithë delegatët shqiptarë në Paris pranuan kalimin e shtetit shqiptar nga kontrolli kolektiv i Fuqive të Mëdha, i vendosur më 29 korrik 1913, në statusin e kontrollit të drejtimit të shtetit shqiptar të pasluftës nga një fuqi e vetme.

Grupi i Turhan Pashës, me të cilin u bashkua Mustafa Kruja dhe pastaj dy anëtarë të tjerë të qeverisë, Mehdi Frashëri e Myfit Libohova (që arritën në Paris në fund të prillit), bëri përpjekje për të arritur në një marrëveshje dypalëshe me qeverinë e Romës. Për të mënjanuar sovranitetin mbi krahinën e Vlorës, ata vendosën t’i njihnin Italisë interesat “strategjike dhe detare” në këtë krahinë, duke pranuar, në rast se Italia do të siguronte tërësinë tokësore të shtetit shqiptar, pushtimin ushtarak të Sazanit, të Karaburunit e të Zvërnecit, si dhe ndërtimin e një baze ushtarake në Pashaliman.

“...Më 28 qershor, grupi i Turhan Pashës bëri ndryshime në përbërjen e delegacionit. Si kryetar i delegacionit në vend të Turhan Pashës u caktua imzot Luigj Bumçi. Mënjanimi i Turhan Pashës, që kish qenë dikur ambasador i Perandorisë Osmane, duket se lidhej me synimin për të ndryshuar sadopak imazhin që propaganda e huaj i vishte me dashakeqësi Shqipërisë si “Turqia e vogël .... Turhan Pasha mbeti përsëri kryeministër....”.

Për Turhan Pashë Përmetin do të vijojë të shkruhet dhe dokumentet do të na afrojnë gjithnjë më shumë në vlerësimin objektiv të këtij personaliteti me rol në historinë e shtetit shqiptar.

Në materialin e radhitur më poshtë, portreti i Turhan Pashë Përmetit jepet sipas opinionit të një personaliteti tjetër të njohur të kohës, Syrja Bej Vlorës, i cili ka dhënë portretizime e opinione të spikatura edhe për Ismail Qemalin, edhe për Esat Pashë Toptanin, etj., edhe për ngjarje e probleme të ndryshme të natyrës politike, ekonomike, sociale, kulturore, arsimore etj., të dekadave të para të shek.XX. Ja ç’thotë Syrja Beu për Turhan Pashë Përmetin:

**Marenglen VERLI**

### ***Turhan Pasha***

*Turhan Pasha, duke i shërbyer Perandorisë Osmane dyzet e katër vjet me ndershmëri dhe sinqeritet kishte arritur në shkallë të larta dhe funksione eprore të Perandorisë dhe kishte fituar famë dhe nderime. Pasi u hoq nga nëpunësia e tij e fundit, që ishte ajo e ambasadorit në Petersburg, u bind dhe e pranoi [detyrën] e kryeministrit të qeverisë sonë të re dhe kështu u kthye në atdheun e tij të parë, që për gjysmë shekulli nuk e kishte parë.*

*Turhan Pasha është i shquar me familjarizimin e tij, në tërë hollësitat, me jetën shoqërore të perëndimit, për shkathtësinë e mendimeve dhe për shkëlqimin e fjalës. Megjithatë herë-herë nxehet, por qetësohet shpejt. Në jetën politike të tij, që i vazhdoi gjashtëdhjetë vjet, më shumë se të jepej pas ndjenjave të tij personale, e kishte bërë zakon t'i rregullonte punët sipas kohës dhe rrethanave. Është hequr nga të rekomanduarit dhe të favorizuarit e një pune, që të ishte thjesht në dobi të një njeriu, prandaj nuk ka pasur miq të singertë. Por, mbasi është ruajtur nga zemërimi dhe nga armiqësia, nuk ka bërë edhe armiq, që mund t'i shkaktonin dëme. Në punë zyrtare nuk ka pasur pavarësi mendimi dhe shumë herë ka rënë në dyshime të kota. Në të gjitha gjuhët e huaja që flet prej kaq vitesh e ka ruajtur aksentin, që është i posaçëm për shqiptarët. Shtati i derdhur dhe pamja e ballit plot delikatesë kurdoherë tërheq vërejtjen dhe respektin dhe ndalon dashakeqësinë për të. Ka fituar miqësinë e posaçme të personaliteteve, që janë shquar prej gjashtëdhjetë vjet e tëhu në jetën politike të Evropës, me të cilët ka pasur relata shoqërore. Është i nderuar në çdo rast dhe në çdo mënyrë me besimin dhe dashamirësinë e shumë sovranëve të botës. Anekdotat që i ka ndërmend rreth këtyre personaliteteve dhe rreth ngjarjeve të ndryshme, i tregon me një mënyrë që të rrëmben dhe të shëron zemrën. U jep shkëlqim rretheve shoqërore. Turhan Pasha është i dhënë shumë pas grave dhe ruhet nga diskutimet. Vetë kishte lindur në Shqipëri, por pasi kishte jetuar shumë vjet jashtë dhe pasi me shqiptarët kishte bërë shumë pak shoqëri, psikologjinë e popullit dhe të vendit dhe nevojat e posaçme të kohës nuk i kishte kuptuar sa duhej. Nga ky shkak nuk pati sukses të ngrinte një administratë të shëndoshë në Durrës. Turhan Pasha në çdo vend dhe kundrejt çdo njeriu deshi të përdorte me të tepërt atë delikatesë, që e karakterizonte dhe i besoi rrethit [të njerëzve] përqark sa nuk duhej dhe, meqenëse gënjehej, atdheu i pa dëmin.*

*Në mes të anëtarëve të Këshillit të Ministrave besimi dhe solidariteti i nevojshëm mungonte. Cilido ministër donte t'i hipte sipër tjetrit dhe [kërkonte që] dëshira e mendimi i tij të dëgjohej dhe të pranohej.*

*Turhan Pasha, duke pohuar se nuk i njihnte nevojat e vendit, çdo punë me qëllim të mirë ua kishte lënë shokëve në dorë. Po këta për mbarëvajtjen e punëve nuk i jepnin ndihmën e vërtetë dhe nuk i tregonin sinqeritet. Kur në Durrës, mori zjarr kryengritja, [rebelimi i Shqipërisë së Mesme] Turhan Pasha, për të kërkuar ndihmë nga qeveritë e Evropës dhe që me ndihmën e sinqertë që do të vinte nga jashtë, të shpëtonte Shqipërinë nga ky hall, shkon e vizitoi kryeqytetet një nga një. Por ndonjë përkrahje nuk pa dhe i hidhëruar dhe i shqetësuar u kthye në Durrës. Mirëpo mbasi zjarri i kryengritjes e kishte rrethuar tërë qarkun dhe për shuarjen e këtij zjarri nuk kishte mbetur mundësi, u shtërngua ta lerë Durrësin duke hipur në anijen ku*

*kishte hipur sovrani. Gjatë Luftës Botërore i kaloi ditët në Zvicër në një gjendje ekonomike të padurueshme.*

*Duhet pohuar se gjithë qëllimet dhe veprimet e Turhan Pashës ishin të pastërta, të zhveshura nga çdo interes mjerman dhe nga qëllimet personale. Drejtësia dhe dashuria e tij për atdheun ishin më lart nga sa mund të mendohet. Pas armëpushimit, u bë kryetar i Qeverisë fantazëm në Durrës dhe u përpoq tepër pranë Konferencës në Paris për shpëtimin e Shqipërisë.*

*Meqenëse Esat Pasha ishte vegla e politikës dhe të ambicieve të mbretërive besëlidhura, Turhan Pasha atë e rrëzoi nga sundimi dhe nga fuqia, po ashtu i hoqi të drejtën të përfaqësonte Shqipërinë. Pati sukses të bënte të dëgjoheshin ankimet dhe kërkesat e mërgatës si krah kombëtar, që ai vetë e kryesonte. Kështu mbrojti pavarësinë tonë që kishte humbur. U përpoq më tepër që vendi ynë të përfitonte nga reputacioni i tij personal të cilin e kishte në mes atyre që mbanin frerët e qeverisjes në botë, sepse në Konferencën e Londrës vendi ynë, mbasi ishte bonjak [jetim] dhe pa njeri, u zhvesh nga shumica e pjesëve kryesore dhe pësoi dëme të hidhura dhe të mëdha. Në çështje të mbrojtjes qeveria provizore e asaj kohe tregoi pakujdesi.*

*Mbretëria e Italisë, për formimin e një mërgate në emër të qeverisë që ishte në Shqipëri, tregoi dashamirësi dhe këtë mërgatë e udhëhoqi deri në Paris. Por ajo nuk donte kurrë që ky rem pjellor dhe i lënë në mes të udhës, i politikës, të prezantohej në kokë të vet dhe të vepronte pa fre. Këtë qeveria italiane nuk e gjente të pajtueshme me gjendjen dhe situatën e saj, si dhe me interesat e shpresat që ajo ushqente.*

*Turhan Pasha me sjelljet e tij të matura e të urta, mënjanoi çdo kundërshtim dhe ndrojtje të italianëve. Edhe sikur të vërteta të jenë pretendimet e atyre që thonë se Turhan Pasha bëri më shumë dhe i fërkoi tepër italianët, prapë se prapë ai diti të rregullojë punët dhe të sigurojë dobi për atdheun tonë. Prandaj besoj se ai meriton respektin dhe emri i tij i nderuar duhet të kujtohet dhe të çmohet.*